


# ANALIZA E PROCESIT TË ZGJEDHJES SË STAFIT AKADEMIK NGA KONKURSI 3/671 2016-2017 NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS



# HYRJE

Universiteti i Prishtinës (UP) është bartësi kryesor i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Kjo vërtetohet nga numri më i madh i studentëve dhe të diplomuarve, por edhe me faktin që UP është institucioni arsimor i ranguar më së larti në platformat matëse. Shtojmë këtu edhe faktin që shumica e mësimeve në të gjitha nivelet arsimore në vend vijnë prej UP-së, rëndësia e tij bëhet kryesore për cilësinë e arsimit në vend.

Marrë parasysh edhe kontekstin historik të kontributit të UP-së në përpjekjet politike të Kosovës deri në arritjen e pavarësisë mund të thuhet se UP-ja ka një vend të rëndësishëm në shoqërinë e sotme kosovare. Kjo bën që përkujdesja dhe mbikëqyrja e veçantë nga të gjithë akterët civil dhe shtetërorë të jenë të shtuara. ORCA po ashtu bën pjesën e saj duke u angazhuar në çështje të zgjedhjes së stafit akademik dhe avancimit të tyre.

Së fundmi ORCA ka bërë hulumtimin kandidatëve nga buletinet e konkursit 3/671 për zgjedhjen e stafit të ri akademik në UP1. Ky ka qenë procesi më i gjatë i avancimeve dhe zgjedhjes së stafit akademik i cili ka zgjatur rreth 6 muaj. ORCA është përfshirë në të pas daljes së rezultateve të para të tij me ç'rast ORCA ka reaguar lidhur me avancimet jashtëstatutare dhe jologjore.

Pas një bllokimi prej gati dy muajsh të cilët kanë qenë muaj të debatit mes menaxhmentit dhe akterëve të shoqërisë civile, ndërkohë që ORCA ka avokuar për ringritjen e kriterëve në nivel të zbatimit, procesi ka rifilluar në muajin prill dhe është përmbyllur në muajin qershor.

ORCA ka kaluar nga roli i kritikuesit post-festum në një rol konstruktiv brenda procesit. Me rifillimin e procesit të shqyrtimeve nga ana e Senatit, ORCA ka përgatitur raporte të detajuara për secilin kandidat në procesin e avancimit dhe i ka ndarë ato me të gjithë senatorët dhe menaxhmentin duke i informuar ata për detajet e gjetjeve rreth kandidatëve që prisnin për avancim. ORCA ka shqyrtuar vetëm kriterin e punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare.

Në fund të procesit ORCA është ndarë e kënaqur me punën e menaxhmentit dhe Senatit të cilët kanë luajtur rol përgjithësisht konstruktiv në zbatimin e kriterit të punimeve shkencore.

---

1 Ky hulumtim është bazuar në raportet e monitorimit të drejtëpërdrejtë të Senatit nga hulumtuesit e ORCA-s. Verifikimi i raporteve të monitorimit është bërë përmes ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve përkatëse të Senatit.

# PËRMBLEDHJE REZULTATESH

Nga konkursi për zgjedhjet në grada akademike në Universitetin e Prishtinës numër 3/671, me datë 24.11.2016, 131 kandidatë janë vlerësuar pozitivisht nga komisionet vlerësuese të përbëra nga profesorë kolegë të kandidatëve.

Këta **131** kandidatë janë të ndarë në: **49** për titullin profesor asistent, **37** për profesor të asocuar, dhe **45** për titullin profesor i rregullt.

Nga 131 kandidatët, ORCA ka vlerësuar që **74 prej tyre nuk i përmbushin kriteret minimale** të kërkuara nga Statuti i Universitetit të Prishtinës për punime në revista shkencore, dhe **57** janë vlerësuar pozitivisht **duke arritur përmbushjen e kriterit minimal** prej një, tre ose pesë punimesh respektivisht për secilin titull akademik.

Për secilin nga 74 kandidatët ORCA i ka dërguar raport të detajuar rreth gjendjes së publikimeve shkencore të tyre, senatit të UP-së.

Nga 74 kandidatë të cilësuar si të përshtatshëm për zgjedhje në titullin përkatës nga ORCA dhe të raportuar në Senat, **70 prej tyre nuk janë zgjedhur**. 4 të zgjedhurit jashtë 74 kandidatëve të përmendur edhe pse janë

shqyrtuar nga ana e menaxhmentit me metodologji të përafërt me ORCA-n, kanë qenë raste me mundësi interpretimesh të ndryshme. Revistat në të cilat kanë publikuar në kohë të caktuar kanë qenë të indeksuara në platforma të indeksimit, mirëpo më vonë ato janë bërë pjesë e listave të revistave të dyshimta.

**Margjina e mospërputhjes mes gjetjeve të ORCA-s dhe menaxhmentit të UP-së e rrjedhimisht vendimeve të Senatit është rreth 5%.**

Nga 57 kandidatë të cilët ORCA i ka vlerësuar pozitivisht, Senati po ashtu i ka vlerësuar pozitivisht duke i avancuar apo rizgjedhur sipas rekomandimeve nga komisionet 48 prej tyre. 9 të tjerë nuk janë shqyrtuar brenda afatit ligjor të konkursit.

**Margjina e mospërputhjes mes gjetjeve të ORCA-s dhe menaxhmentit të UP-së e rrjedhimisht vendimeve të Senatit për rastet e vlerësuara pozitivisht është rreth 8%.**

# PËRMBLEDHJE REZULTATESH TË ANALIZËS SË PROCESIT TË ZGJEDHJES SË STAFIT AKADEMIK NGA KONKURSI 3/671 2016-2017 NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

## REZULTATET PËR TITULLIN PROFESOR ASISTENT

Nga 49 kandidatë për profesorë asistentë që janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës, ORCA ka vlerësuar si të përshtatshëm për zgjedhje në titullin përkatës 28 kandidatë:

- 19 kandidatë janë zgjedhur profesor asistent
- 5 kandidatë janë rizgjedhur
- 4 kandidatë nuk janë shqyrtuar brenda afatit ligjor të konkursit

Nga 21 kandidatët që ORCA i ka cilësuar si të papërshtatshëm për zgjedhje në titullin përkatës:

- 5 kandidatë janë refuzuar
- 13 kandidatë nuk janë shqyrtuar brenda afatit ligjor të konkursit
- 3 kandidatë janë rizgjedhur në të njëjtin titull

## REZULTATET PËR TITULLIN PROFESOR I ASOCUAR

37 profesorë kanë konkurruar për gradën profesor të asocuar. ORCA ka vlerësuar të cilësuar si të përshtatshëm për zgjedhje në titullin përkatës 12 kandidatë.

- 10 kandidatë janë zgjedhur në pozitën e profesorit të asocuar
- 1 kandidat është rizgjedhur
- 1 kandidat nuk është shqyrtuar brenda afatit ligjor të konkursit

Prej 25 kandidatëve që ORCA i ka cilësuar si të papërshtatshëm për zgjedhje në titullin përkatës për avancime:

- 19 kandidatë janë rizgjedhur profesorë asistentë ose të asocuar<sup>2</sup>.
- 3 kandidatë janë avancuar në titullin e profesorit të asocuar
- 3 kandidatë nuk janë shqyrtuar brenda afatit ligjor të konkursit

## REZULTATET PËR TITULLIN PROFESOR I RREGULLT

Nga 45 kandidatë për profesorë të rregullt që janë rekomanduar pozitivisht nga komisionet vlerësuese të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës.

ORCA ka cilësuar si të përshtatshëm për zgjedhje në titullin përkatës 17 kandidatë, sa i përket përmbushjes së kriterit të punimeve shkencore.

- 12 kandidatë janë avancuar
- 4 kandidatë nuk janë shqyrtuar brenda afatit ligjor të konkursit
- 1 kandidat është rizgjedhur në gradën profesor i asocuar

Prej 28 kandidatëve që ORCA i ka cilësuar si të papërshtatshëm për zgjedhje në titullin përkatës:

- 1 kandidat është avancuar
- 16 kandidatë janë rizgjedhur në gradën profesor i asocuar.
- 11 kandidatë nuk janë shqyrtuar brenda afatit ligjor të konkursit

---

2 13 nga ta kanë synuar mbetjen në titullin e njëjtë dhe kanë mbetur në po atë titull, atë të profesorit të asocuar. 6 të tjerë, kanë synuar avancimin nga grada e profesorit asistent në atë të profesorit të asocuar, mirëpo kanë mbetur në pozitën e profesorit asistent.

# METODOLOGJIA

Metodologjia për analizimin e rasteve të punësimeve apo avancimeve në buletinet e cekura është mbështetur mbi:

1. Statutin e Universitetit të Prishtinës, gjegjësisht Nenin 175, 176 dhe 177.
2. Rekomandimin 1/344 e Senatit për publikimet shkencore relevante për punësim apo avancim akademik. Ky rekomandim është marrë parasysh vetëm në rastet kur nuk ka qenë në kundërshtim me Statutin, pasi ORCA ka publikuar analiza të saj që argumentojnë kundërthëniet e rekomandimit me Statutin e UP-së.

Në rast të mospërputhjeve mes Statutit dhe Rekomandimit, ORCA i ka dhënë përparësi rregullativës së përcaktuar në Statut të UP-së dhe Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë.

**Për pozitën profesor asistent**, personi duhet të ketë të botuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recenzion, relevante sipas Statutit të UP-së dhe Rekomandimit të Senatit, si autor i parë apo korrespondent.

**Për pozitën profesor të asocuar**, personi duhet të ketë të botuar të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante sipas Statutit të UP-së dhe Rekomandimit të Senatit, si autor i parë apo korrespondent.

**Për pozitën profesor të rregullt**, personi duhet të ketë të botuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante sipas Statutit të UP-së dhe Rekomandimit të Senatit, si autor i parë apo korrespondent.

ORCA ka bërë vlerësimin e revistave dhe radhën e autorësisë së punimeve, për t'i cilësuar si relevante apo jo publikimet shkencore të kandidatëve të paraqitur në buletine.

Duke u bazuar në rregulloret e cekura, ORCA nuk i ka cilësuar si publikime relevante punimet të publikuara në përmbledhje konferencash, raporte, projekte apo libra të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare.

Punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë botuar, nuk vlejnë sipas Statutit të UP-së dhe si të tillë ORCA nuk i ka cilësuar si punime shkencore relevante.

Publikimet në revista shkencore rajonale, sipas Rekomandimit të Senatit për të qenë relevante duhet të jenë të indeksuara në të paktën njërin nga databazat indeksuese akademike Scopus apo Web of Science. Rrjedhimisht ORCA nuk i ka cilësuar si relevante publikimet në revista rajonale jashtë këtyre databazave.

Punimet të cilat janë të publikuara vetëm si abstrakte dhe që as me anë të abonimit në revistën përkatëse nuk mund të shihen të plotë, ORCA nuk i ka cilësuar si publikime relevante për kriterin e përmendur.

Punimet e publikuara në revistat e dyshimta, nuk janë marrë për bazë si punime shkencore relevante. Metodologjia e përdorur nga ORCA për identifikimin e revistave të dyshimta mbështetet në parimet e transparencës të përpiluara nga disa prej organizatave më prestigjioze të botimeve shkencore: Committee on Publication Ethics (COPE), Directory of Open Access Journals (DOAJ), Open Access Scholarly Publishers Association (OASPA), World Association of Medical Editors (WAME).

Sipas parimeve të vendosura dhe në pajtim me akademikë vendorë dhe ndërkombëtarë, ORCA ka formuluar disa kushte bazike që një revistë serioze shkencore duhet t'i përmbushë që të konsiderohet serioze:

- 1.** Revista duhet të ketë staf redaktorial të rregullt, i cili përbëhet nga persona të vërtetë dhe emrat e të cilëve janë shkruar në mënyrë të qartë dhe të plotë. Redaktorët duhet të jenë kompetentë, të specializuar në fushën që trajton revista.
- 2.** I njëjti staf redaktues nuk mund të jetë i njëjti në dy revista të fushave krejt të ndryshme. Duhet të ketë një sistem të qartë të recenzionit të punimeve nga akademikë homologë të fushave përkatëse (ang. peer review process), përveç rasteve të veçanta për materiale specifike, çka duhet cekur qartë nga revista.
- 3.** E drejta e autorit dhe informacionet e licensimit duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë në faqen e internetit të revistës, dhe kushtet e licensimit duhet të tregohen në të gjithë artikujt dhe duhen botuar si HTML ose si PDF.
- 4.** Revista duhet të ketë një adresë të saktë fizike; një adresë email të posaçme dhe funksionale, krahas të dhënave të tjera të vërteta dhe të verifikueshme.
- 5.** Informatat në lidhje me pronësinë dhe/ose menaxhimin e revistës do të tregohen qartë në faqen e internetit të revistës. Botuesi nuk do të përdorë emra organizate që do të mund t'i çorientojnë autorët dhe redaktorët potencialë në lidhje me natyrën e pronësisë së revistës.
- 6.** Në rastet kur impakt faktori i revistës deklarohet në faqen e saj, ai duhet të jetë real dhe jo në mospërputhje me impakt faktorin që gjendet në indeksat përkatëse me reputacion botëror.
- 7.** Në ato raste kur për të botuar një punim në një revistë nevojitet që autori të paguajë, diçka e tillë duhet specifikuar në mënyrë të qartë në faqen e revistës.
- 8.** Faqja e internetit e një reviste, duke përfshirë edhe përmbajtjen e saj, duhet të tregojë se i është dhënë kujdes i veçantë për të siguruar standarde të larta etike dhe profesionale. Ajo duhet të ketë lidhje funksionale dhe me informacion të përditësuar, përveç rasteve kur (vetëm) në afate të kufizuara kohore, faqja mund të mos jetë funksionale për shkak të mirëmbajtjes apo problemeve teknike.
- 9.** Emri i revistës duhet të jetë unik dhe të mos jetë riprodhim identik i emrit që i përket një reviste tjetër. Gjithashtu, revista duhet të ketë kod ISSN, si kriter i domosdoshëm por jo i mjaftueshëm.

Gjithashtu, tregues shtesë por jo përcaktues mbi integritetin e një reviste shkencore janë:

1. Nëse ekipi redaktorial i revistës kanë angazhim relevant shkencor në fushat përkatëse dhe nëse anëtarët e redaksisë së revistës publikojnë vazhdimisht në atë revistë.
2. Nëse kontakte funksionale të ekipit redaktorial janë të qasshme në faqen e revistës.
3. Nëse revista promovon faktin që është e listuar në indekse të dyshimta apo çorientuese si rasti i Index Copernicus etj. Një revistë serioze nuk duhet të promovojë listimin në indekse joserioze.
4. Periodiciteti me të cilën publikohet revista duhet të shprehet qartë dhe nuk duhet të jetë subjekt i luhatjeve drastike në kohë.
5. Nëse punimet e botuara në një revistë karakterizohen nga gabime gjuhësore (anglisht) apo gramatikore. Çdo revistë serioze duhet të ketë kapacitete të redaktimit gjuhësor/kuptimor.
6. Nëse punimet e botuara në një revistë karakterizohen me deformime estetike ose nuk janë të shkruara në formatin që revista e kërkon. Për shembull, dy punime në të njëjtën revistë janë shkruar në stile të ndryshme ose një punim në disa pjesë është shkruar me një stil/format e në disa faqe të tjera është shkruar me një tjetër.

Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për Fakultetin e Arteve. Rrjedhimisht, kandidatët e Fakultetit të Arteve nuk marrin pjesë në hulumtimin e ORCA-s.

ORCA nuk paragjykon dijeninë apo qëllimshmërinë e autorëve sa i takon botimeve të tyre në revista të dyshimta, por është mjaftuar të evidentojë situatën mbi faktin e kryer.



# PËRFUNDIME

Mosplotësimi i kriterit të publikimeve shkencore nga kandidatët e konkursit 3/671 vazhdon të mbetet real edhe pas kritikave nga raporti i kaluar i ORCA-s dhe shqetësimeve të organizatave të tjera të shoqërisë civile.

Një numër i madh parregullsisht janë shënuar te raportet e komisioneve vlerësuese pranë fakulteteve përkatëse, për kandidatët e propozuar. Listimet e aktivitetit shkencor kanë qenë në raste të shumta të gabuara. P.sh: në rastet kur punimi ka qenë kontribut në libër është paraqitur si publikim shkencor në revistë shkencore; apo rastet e pjesëmarrjes në konferenca janë listuar po ashtu si publikime shkencore në revista shkencore.

Komisionet vlerësuese po ashtu në shumicën e rasteve kanë vlerësuar që kandidatët janë autorë korrespondent pa paraqitur fakte të mjaftueshme që e vërtetojnë këtë gjë.

Shqetësim të veçantë përbëjnë rastet kur anëtarët e komisionit vlerësues kanë vlerësuar punimin ku dhe vetë kanë qenë koautor.

Shqetësues është edhe fakti i mungesës së mentorimeve të doktoratave nga kandidatët e propozuar për titullin e profesorit të rregullt.

ORCA vlerëson një punë përgjithësisht të mirë të Senatit të UP-së. Raportet e kandidatëve të cilat u janë dërguar senatorëve rezultojnë të suksesshëm në vlerësimet e tyre sa i përket avancimit të kandidatëve në grada më të larta. Po ashtu komisioni i studimeve pranë senatit të UP-së i ka paraqitur anëtarëve të senatit vlerësimet e afërta me ato të ORCA-s sa i përket avancimit të kandidatëve në grada më të larta, ku në vetëm 4 prej 45 sosh nuk ka pasur përputhje të plotë.

Rastet e kandidatëve që kanë mbetur pa vendim të senatit për arsye të shtyrjes së vazhdueshme paraqesin një koordinim të dobët nga njësitë akademike me sekretariatit të UP-së.

Për ORCA-n shkelje vazhdon të paraqet kategoria jo-statutare, "rizgjedhja". Kandidatët të cilët janë propozuar për titullin e njëjtë akademik janë zgjedhë me automatizëm, pa vlerësim të kriterëve nga Senati. Kandidatët tjerë që kanë konkuruar për pozitën e njëjtë me kandidatin që është "rizgjedhur" nuk janë marrë parasysh edhe në rastet kur ata potencialisht do të ishin më të përshtatshëm për pozitë përkatëse sipas statutit të UP-së. Për këtë gjë ORCA ka dërguar dy ankesa në Inspektorat të Arsimit për ato raste për të cilat ka vlerësuar se nuk kanë plotësuar kriteret e caktuara sipas statutit të UP-së.

**Prishtinë, nëntor 2017**

Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), dhe me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupsionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së, KCSF-së apo KFOS-it.

